



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 4.2.2016, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së, Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së, Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së dhe Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së.

Mungoi: Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Osman Bllaca, këshilltar i Kryetarit të Komunës, Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, Mustafë Neziri, zyrtar i Zyrës komunale për kthim, si dhe përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Lirak Çelaj** propozoi që të shtohen edhe dy pika të rendit të ditës:

- 1. Caktimi i lokacionit për kishën dhe varrezat protestante dhe**
- 2. Shqyrtimi i vendimit të peticionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik.**

Ai ceku se peticioni është trajtuar një herë, por për shkak të ndryshimeve dhe kriterëve që kanë ardhur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duhet të miratohet një vendim i ri prej Kuvendit konform atyre qëndrimeve.

Kryesuesi theksoi se edhe më herët është diskutuar lidhur me çështjen e lokacionit për kishën dhe varrezat protestante dhe peticionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re”. Kemi pritur që ekzekutivi do t’i sjellë materialet që kanë të bëjnë me këto pika, mirëpo në zyrën e Kuvendit ato nuk ka ardhur.

Dardan Sejdiu bëri të ditur se çështja e caktimit të lokacionit për kishën dhe varrezat protestante, është proces që nuk mund të zgjidhet për një kohë të shkurtër. Drejtoria përkatëse duhet të merret me këtë çështje dhe në momentin që do të kemi propozimin për lokacion, do ta sjellim për shqyrtim.

Lirak Çelaj kërkoi që të procedohet me parcelën që është propozuar në lagjen “Arbëria”, pasi që aty janë edhe varrezat e tjera të krishtere dhe ortodokse, qoftë edhe varreza të përkohshme, derisa ta hartojë Komuna projektin për varrezat e përbashkëta për të gjitha religjionet, vetëm t’i bashkëngjitet një aneks. Kjo është në përputhshmëri me Planin rregullues të lagjes “Arbëria”, dhe kanë pëlqimin prej institucioneve tjera ekzistuese që janë aty për këtë çështje. Sa i përket numrit të parcelës, mund t’ua sigurojmë një ditë, aty ka qenë në plan të ndërtohet Pishina olimpike, është e njëjta parcelë. Pra, të futet në rend dite dhe ta miratojmë një vendim të tillë.

Dardan Sejdiu sqaroi se për shkak të specifikave të asaj hapësire, nuk është menduar nga drejtoria përkatëse që ajo parcelë e paraparë për zonë rekreative, tani të kthehet në zonë varrezash, kjo ka të bëjë me Planin rregullues.

Kryesuesi shprehu mendimin se këtë mund ta fusim në rend dite, mirëpo tani për tani nuk kemi material, andaj për mbledhje të Kuvendit duhet të dërgohet materiali nga ana e ekzekutivit.

Ardian Olluri theksoi se çështja e pronës është kompetencë e Kuvendit. Kuvendi mund të vendosë, mirëpo është miratuar Plani rregullues që nuk parasheh varreza. Nëse jepet për varreza, atëherë duhet të ndryshohet Plani rregullues dhe kjo është çështje e Kuvendit.

Sami Hamiti përkrahu futjen e kësaj pike në rend dite dhe propozoi që të bëhet një interpretim, të jetë një pëlqim në parim. Ai tha se planet rregulluese, ku sipas interpretimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor janë 3-4 pika që janë ardhur në rend dite, të cilat në bazë të këtij interpretimi nuk janë në harmoni me atë që shkruan, andaj ekzekutivi duhet t’i drejtohet me urgjencë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për interpretimin e këtyre pikave. Nëse Ministria thotë se ato janë të ligjshme, atëherë ato do të trajtohen në Kuvend, por mendoj se nuk janë të ligjshme.

Qëndron Kastrati shprehu shqetësimin për propozimet që vijnë nga individët nga radhët e Kuvendit të Komunës, qoftë ekspertë të këtyre fushave apo jo. Është kompetencë e drejtorive përkatëse të propozojnë lokacione, qoftë për kishë apo diçka tjetër. Ai kërkoi që si komitet, t’i takojnë përfaqësuesit e këtyre komuniteteve, ku do të kishte edhe sociolog, dhe të debatohet për çështjen e varrezave, të jenë të ndara sipas religjioneve apo jo, dhe të bisedojmë me GP-të se si të merret vendimi.

Islam Pacolli kërkoi që të zgjidhet kjo çështje. Ai shprehu qëndrimin se nëse kjo pikë silllet në Kuvend, grupi i tyre parlamentar do ta përkrah për miratim.

Dardan Sejdiu përkrahu futjen e kësaj pike në rend dite, në mënyrë që ekzekutivi të përpiket ta sjellë materialin në Kuvend, e nëse kjo nuk arrihet, atëherë të vijnë me arsyetim.

Kryesuesi konstatoi se anëtarët e Komitetit u pajtuan që të futet në rend dite pika: – Caktimi i lokacionit për varrezat dhe kishën protestante, me sugjerimin që për mbledhjen e Kuvendit ekzekutivi ta sjellë materialin, e nëse nuk mund ta sjellë materialin, atëherë të përcillet me arsyetim.

Kryesuesi theksoi se sa i përket petitionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik, kërkesa ka qenë në Kuvend, është marrë një vendim, është miratuar kërkesa e banorëve dhe i është dërguar drejtorisë përkatëse ta shqyrtojë sipas ligjit.

Sa i përket shkresës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kur është caktuar rendi i ditës, nuk është ditur se do të arrijë një shkresë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, tani e kemi në rend dite edhe shkresën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku sipas saj thuhet se mbesin në fuqi planet ekzistuese dhe nuk mundë të hyhet në ndryshime dhe plotësime të planeve rregulluese.

Ardian Olluri dha sqarime lidhur me shkresën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Kryesuesi tha se procedimi i këtyre pikave në bazë të kësaj shkrese, është në kundërshtim me ligjin.

Ardian Olluri tha se Udhëzimi administrativ nr. 45, i rregullon elementet themelore të planit rregullues urban, përmbajtje d.m.th. dhe Ligji thotë: Nëse të vetmin kusht që nuk janë në kundërshtim me ligjin e ri, planet e reja rregulluese mund të bëhen në bazë të këtij udhëzimi. Këto janë me kusht që të mos jenë në kundërshtim me ligjin e ri, e besoj se këto janë në përputhje me ligjin e ri dhe Udhëzimi administrativ që rregullon përmbajtjen. Ligji e lë Udhëzimin administrativ derisa të nxirret ligji i ri.

Islam Pacolli, lidhur me shkresën e Ministrisë, kërkoi që të japë sqarime ish-shefi i Zyrës ligjore, z. Agim Salihu, që të sqarohet mirë kjo çështje dhe të mos dërgojmë diçka që është ndesh me ligjin.

Agim Salihu dha sqarime lidhur me shkresën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Hazir Borovci shprehu mendimin se mund t’i procedojmë këto pika, por të sqaruara ligjërisht. Në mbledhjen tjetër duhet të kërkojmë përgjigje në aspektin e ligjshmërisë, nëse ka shkelje të ligjshmërisë, atëherë nuk kemi çka të diskutojmë fare.

Kryesuesi theksoi se me pajtimin e Komitetit, në bashkëpunim me Zyrën ligjore, ne mund të bëjmë shkresën dhe t’ia dërgojmë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Nëse na kthehet përgjigjen brenda afatit të caktuar që kemi të drejtë, për Kuvend i procedojmë, nëse kthehet përgjigja kështu siç është nuk i procedojmë.

Dardan Sejdiu theksoi se ekziston konfirmimi i ligjshmërisë, andaj duhet të ecet përpara. Do të konsultohem me shefin e Zyrës ligjore, por do ta ftoj edhe ish-shefin e Zyrës ligjore, z. Agim Salihu, dhe do ta trajtojmë këtë çështje.

Laura Zherka tha se planet rregulluese nuk janë në fuqi me ligjin e ri. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk e ka miratuar Udhëzimin administrativ për planet e hollësishme, e dimë se ligji është më i fuqishëm se udhëzimi administrativ, andaj duhet mbështetur në Ligjin e Planifikimit Hapësinor, sepse planet rregulluese urbane nuk janë në fuqi.

Lirak Çelaj propozoi që të mbesin pikat në rend dite, por të kërkohet interpretim nga ana e Ministrisë për të marrë përgjigjen e ligjshmërisë.

Qëndron Kastrati u shpreh se përgjigje është interpretimi i akteve ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi. Asnjë akt ligjor ose nënligjor, nuk është ndryshuar nga koha kur është bërë konfirmimi i ligjshmërisë për Planin rregullues “Arbëria 3”. Pra, ekziston një konfirmim për ligjshmërinë e një vendimi, e përgjigja është vetëm thirrja në atë akt ligjor dhe nënligjor.

Kryesuesi u pajtua që pikat të dërgohen për Kuvend dhe të bëhet kërkesë për konsultime paraprake me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues urban të lagjes “Mati 2”;
3. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues urban të lagjes “Sofalia”;
4. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e Trimave 1”;
5. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes “Lakërishta” në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regional natyror “Gërmia” në kategorinë - Peizazh i mbrojtur “Gërmia”;
7. Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta;
8. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës;
9. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale;
10. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;
11. Shqyrtimi i Raportit buxhetor për situatën ekonomiko-financiare të Komunës për periudhën janar - qershor 2015;
12. Shqyrtimi i Raportit buxhetor tremujor, korrik - shtator 2015;
13. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2014;
14. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të një pjese të SHML “Gjimnazi Matematikor” për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme “Atomi”;
15. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private;
16. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
17. Propozimplani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
18. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete;

19. Caktimi i lokacionit për kishën dhe varrezat protestante;

20. Shqyrtimi i vendimit të peticionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik;

21. Të ndryshme.

Lirak Çelaj shtroi pyetje lidhur me mos mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit në muajt dhjetor dhe janar dhe mos përmbajtjen e planit të punës së Kuvendit.

Kryesuesi tha se sipas ligjit është e paraparë që Kuvendi gjatë vitit t’i mbajë dhjetë mbledhje të rregullta. Ne i kemi mbajtur vetëm nëntë mbledhje. Arsye e mos mbajtjes së mbledhjes së dhjetë është se ekzekutivi nuk ka sjellë material.

Lirak Çelaj kërkoi që Plani i punës së Kuvendit të zbatohet, e nëse ka ndonjë pengësë jashtë Kuvendit, asamblistëve, të bëhen publike këto çështje.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë, e tretë, e katërt dhe pestë:

2. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues urban të lagjes “Mati 2”;

3. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues urban të lagjes “Sofalia”;

4. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e Trimave 1”;

5. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes “Lakërishta” në Prishtinë.

Lirak Çelaj u shpreh se, meqë jemi informuar nga mediat se është funksionalizuar drejtoria e re, shpresojmë se do të funksionojë siç na është thënë gojarisht nga kryetari dhe nënkryetari, se këto pika të rendit të ditës pas miratimit do të trajtohen përmes kësaj drejtorie. Nëse është e kundërta, ne prapë do ta mbajmë qëndrimin se nëse vjen ndonjë pikë prej drejtorisë së vjetër dhe që udhëhiqet nga i njëjti person, ne do ta bojkotojmë prapë.

Dardan Sejdiu bëri të ditur se Vendimi për sistematizim është dërguar në ministrinë përkatëse dhe ministria përkatëse i ka përcjellë disa sugjerime, që kanë të bëjnë me zyrtarë e jo me strukturën organizative të Komunës. Planet rregulluese dhe temat që kanë të bëjnë me rregullim hapësinor, kalojnë në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ku drejtor do të emërohet z. Genc Bashota.

Laura Zherka kërkoi sqarime lidhur me drejtoritë e reja dhe kërkoi Organogramin.

Dardan Sejdiu dha sqarime lidhur me formimin e drejtorive të reja dhe shuarjen e disa drejtorive të mëparshme, ndërsa Organogramin do t’a sjellim në momentin që do të miratohet.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrahen pikat 2, 3, 4, dhe 5 të rendit të ditës dhe i dërgohen Kuvendit për shqyrtim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia", dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e shtatë

Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Sa i përket **Propozimrregullores për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, Dardan Sejdiu** propozoi që te neni 60.9 (masat edukativo-disiplinore), të mos jetë shprehja "*gjoha financiare*", por të jetë "*Kompensimi i dëmit të shkaktuar material*", dhe për Kuvend të qartësohet.

Qëndron Kastrati shprehu shqetësimin e GP-së lidhur me çështjen e uniformave, mbarëvajtjen dhe vlerën shumë të lartë të uniformës për secilin nxënës. Është mirë që në këtë rregullore të përfshihet, minimizohet vlera financiare e uniformave dhe të subvencionohen kategoritë e caktuara. Problem tjetër është përdorimi i detyrueshëm i uniformës në shkolla. Ai shfaqti edhe shqetësimin lidhur me sigurinë private në shkolla.

Islam Pacolli pyeti se a ka formë tjetër zyrtare të sigurimit, të formës tjetër, jo prej individi, me arsye individi, me u ndjekur në forma të rregullta ligjore e jo me ndëshkime, gjoha materiale.

Hazir Borovci kërkoi që rregullorja të jetë më e qartë, në mënyrë që t'u shmangemi sa më shumë përshkrimeve të gjatave të neneve dhe ligjeve. Ai shprehu mendimin se nuk janë bërë ndryshimet dhe plotësimet e duhura nga ana e komisionit.

Arbëri Navagaci dha sqarime lidhur me këtë rregullore.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës.

Ferit Fazliu, përfaqësues nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dha sqarime lidhur me këtë propozimvendim.

Sami Hamiti tha se ky vendim realisht është i strukturuar mirë, është punuar mirë, mirëpo taksat janë më të ulëta në regjion, me këtë normë të inkasimit për kompensim, për rregullim të tokës ndërtimore është problem dhe nuk do të ketë mundësi Komuna t'u përgjigjur kërkesave të planeve rregulluese.

Islam Pacolli propozoi që në këtë taksë të përfshihet edhe infrastruktura, në mënyrë që në këtë rregullore pak a shumë, sa të jetë ajo taksë, ta kemi shpresën se do të realizohet infrastruktura. Njëherësh të jetë mirë e theksuar në pikën juridike, që pas pagesës së taksës në bazë të ligjit të ofrohet infrastruktura.

Lirak Çelaj theksoi se rritja e taksave, d.m.th. obligimi ndaj ndërtuesit, si do të ndikojë në çmimin e banesave, sepse kjo do të shkaktojë një rritje të çmimit total, atëherë do ta ngarkojë qytetarin më shumë se ndërmarrësin, andaj jemi në parim kundër kësaj. Po ashtu ceku se ka pasur komente prej Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, se nuk është respektuar baza ligjore për këto taksa. Është mirë të shikohet se a është në përputhje me legjislacionin dhe aktet tjera juridike çështja e taksave.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale.

Kryesuesi sqaroi se ky komision do t'i ketë gjashtë anëtarë. Drejtori i Drejtorisë së Administratës për anëtarë të komisionit i ka propozuar z. Zijadin Gashi, shef i Shërbimit të Kuvendit dhe z. Fadil Leci, shef i BL-ve. Nga Komiteti për anëtarë të komisionit u propozuan: z. Shefki Gashi nga LDK-ja dhe z. Qëndron Kastrati nga VV-ja, ndërsa nga PDK-ja mbetet të jepet propozimi në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale.

Kryesuesi bëri të ditur se ky komision do t'i ketë nëntë anëtarë. Administrata e ka propozuar vetëm z. Zijadin Gashin. Ai propozoi që Zyra ligjore të përfshihet në këtë komision.

Lirak Çelaj pyeti se a është e përcaktuar formula përcaktuese ligjore për formimin e komisioneve, anëtarët e këtyre komisioneve a duhet të jenë të jashtëm apo asamblastë?

Kryesuesi sqaroi se nuk ka formulë përcaktuese për formimin e komisioneve, por mirë do të ishte të përfshihen nga të gjitha partitë.

Lidhur me këtë çështje diskutuan edhe Sami Hamiti dhe Islam Pacolli.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e njëmbëdhjetë, e dymbëdhjetë dhe e trembëdhjetë:

-Shqyrtimi i Raportit buxhetor për situatën ekonomiko-financiare të Komunës për periudhën janar - qershor 2015;

- Shqyrtimi i Raportit buxhetor tremujor, korrik - shtator 2015;

- Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2014.

Kryesuesi u shpreh se tani jemi në muajin shkurt, ndërsa ne po diskutojmë për këto raporte që është dashur të kryhen më herët. Sipas kërkesës së Ministrisë së Pushtetit Lokal drejtuar Kryetarit dhe Kuvendit, e ka obliguar Kryetarin që këto pika të rendit të ditës të futen si pika të veçanta në rend dite.

Lirak Çelaj propozoi që këto tri pika: 11, 12, dhe 13 të hiqen nga rendi i ditës, janë të devaluara. Këtu Kryetari e ka shkelur Ligjin me mos raportimin para Kuvendit, që e ka obligim ligjor të raportojë së paku dy herë në vit.

Sami Hamiti e përkrahu mendimin e shprehur nga z. Çelaj, sepse këto tani janë konsumuar dhe tejkaluara. Shqyrtimi i këtyre raporteve tani në këtë kohë nuk ka kurrfarë vlere. Që nga fillimi ka qenë kërkesë e jona, sepse është obligim ligjorë me raportuar Kryetari së paku dy herë. Për këto raporte dy herë dhe sa herë të kërkohet në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që pikat: 11,12 dhe 13 të shkojnë për Kuvend, e atje të vendoset se a do të diskutohen.

Pika e katërbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të një pjese të SHML "Gjimnazi Matematikor" për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme "Atomi".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të një pjese të SHML "Gjimnazi Matematikor" për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme "Atomi" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pesëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private.

Kryesuesi theksoi se i kemi vendimet dhe arsyetimet lidhur me këmbimin e këtyre pronave, mirëpo u mungojnë propozimet e Kryetarit.

Sami Hamiti tha se duhet të jetë një propozim paraprak nga Kryetari.

Kryesuesi propozoi që të procedohen për Kuvend, por me kusht që në Kuvend të dërgohen propozimet të nënshkruara nga Kryetari.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private, me kusht që për Kuvend të dërgohen propozimet nga Kryetari, në mënyrë që të shqyrtohen në Kuvend.

Pika e gjashtëmbëdhjetë

Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016

Kryesuesi tha sa i përket vendimit për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016, jemi vonuar, pasi që nuk kemi mbajtur mbledhje më herët. Vitin e kaluar në dhjetor është formuar komisioni, e në mbledhje të janarit ka qenë i hartuar plani i punës së Kuvendit. Ai i ceku emrat e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit që kanë qenë vitin e kaluar.

Qëndron Kastrati propozoi që formula të mbetet e njëjtë, ndërsa anëtarët e subjekteve të mund të ndërrohen.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah, që në mbledhjen e Kuvend të dalin me propozime për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.

Pika e shtatëmbëdhjetë

Propozimplani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Kryesuesi tha se ky vendim është i përgatitur shumë mirë.

Mustafe Neziri informoi lidhur me Propozimplanin lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimplani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tetëmbëdhjetë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete.

Mustaf Neziri tha se është fjala për ndërrimin e një anëtari të Komitetit për Komunitete dhe zëvendësimin e tij me një anëtar tjetër. Ka qenë Fikreta Kandiçi, nga komuniteti boshnjak, dhe tash e tutje do të jetë Hakija Kandiçi, nga komuniteti boshnjak.

Sami Hamiti përshëndeti Ibrahim Mehmetajn, duke thënë se është vendim i partisë që të jetë tash e tutje shef i GP të AAK-së, por nuk është formalizuar në Kuvend. Ai e sugjeroi kryesuesin që kjo çështje të formalizohet juridikisht në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi theksoi se në Kuvend do ta formalizojmë këtë çështje, sepse Ibrahim Mehmetaj tash e tutje do të jetë shef i GP të AAK-së.

Qëndron Kastrati sugjeroi ekzekutivin, apo kushdo që është propozues lidhur me zgjedhjen e një anëtari të ri të Komitetit për Komunitete, që në të ardhmen është mirë që subjekti politik që i përfaqëson komunitetet ku munden me qenë dy apo tri subjekte mos me qenë propozues, por propozues me qenë komuniteti ose forma tjera, se unë e di komuniteti ashkali është i pakënaqur me përfaqësues.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntëmbëdhjetë dhe e njëzetë:

- Caktimi i lokacionit për kishën dhe varrezat protestante;
- Shqyrtimi i vendimit të peticionit të banorëve të lagjes “Prishtina e Re” lidhur me Planin urbanistik.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah që pikat 19 dhe 20 të shkojnë për Kuvend, me sugjerimin që në Kuvend ekzekutivi të sjellë materialin, nëse jo, atëherë të përcillet me arsyetim.

Mbledhja përfundoi në orën 17:35

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi dhe
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.